

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

VENDIM
Nr.781, datë 14.11.2007
I NDRYSHUAR

**PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE E FUNKSIONALE TË PAJISJEVE FISKALE,
SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR TRANSFERIMET PERIODIKE,
AUTOMATIKE, TË DEKLARIMEVE FINANCIARE, SISTEMIT TË KOMUNIKIMIT, PËR
PROCEDURËN E DOKUMENTACIONIN PËR MIRATIMIN E TYRE DHE PËR KRITERET
PËR PAJISJEN, ME AUTORIZIM, TË SHOQËRIVE TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E
PAJISJEVE FISKALE**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Detyrimi për instalimin e pajisjeve fiskale

Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, ose në sektorët e veçantë të përcaktuar në këtë vendim apo në udhëzimet e Ministrisë së Financave, janë të detyruar të përdorin pajisje apo sisteme fiskale, për regjistrimin e qarkullimit, duke lëshuar kuponin tatimor.

2. Pajisja fiskale dhe sistemi fiskal

2.1 Pajisja fiskale është një regjistruer elektronik fiskal ose një printer fiskal (i cili është analog i regjistruerit elektronik fiskal) që përdoren si pajisje më vete apo e përfshirë në pikën e shitjes.

Pajisja fiskale përbëhet nga:

- a) memorie operative RAM;
- b) memoria fiskale;
- c) qarku i shiritit kontrollit elektronik (QSHKE);
- ç) program i logjikës së pajisjes fiskale (Firmware);
- d) transmetuesi i të dhënave, pjesë përbërëse ose e bashkëngjitur;
- dh) printuesi i kuponit.

Pajisjet fiskale bëjnë regjistrimin e të dhënave për vlerën e mallrave të shitura dhe të shërbimeve

të kryera për klientët, në shiritin e kontrollit elektronik dhe në memorien fiskale, duke siguruar në këtë mënyrë gjenerimin e raporteve të veçanta;

2.2 Sistemi fiskal për sektorë të veçantë ka kërkesa të veçanta, të cilat miratohen në përputhje me legjislacionin.

3. Sistemi i integruar kompjuterik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Sistemi i integruar kompjuterik në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për transferimin periodik, automatik, të deklarimeve financiare dhe përpunimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave

nga ekspertët tatimorë, është një sistem, që përmbledh të gjitha transferimet periodike të raporteve tatimore ditore të pajisjeve fiskale.

4. Sistemi i komunikimit për transmetimin e të dhënave

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

Sistemi i komunikimit ndërmjet tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, realizohet nëpërmjet një rrjeti të sigurt transmetimi të dhënash të nënshkruara në mënyrë elektronike.

Tatimpaguesit duhet të realizojnë kalimin e raporteve tatimore të pajisjes fiskale në mënyrë periodike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet sistemit të sigurt të transmetimit të të dhënave GPRS. Sistemet fiskale duhet të sigurojnë transmetimin e çdo shitjeje në kohë reale në serverin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet sistemeve të transmetimit GPRS/3G/UMTS/LTE etj.

Transmetimi i të dhënave të xhiros në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve bëhet pas mbylljes së raportit tatimor ditor në mënyrë automatike. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përshtat infrastrukturën në bazë të marrëveshjes që bëjnë shoqëritë e autorizuara me operatorin e telefonisë celulare për sigurimin e shërbimit sipas kësaj skeme.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

(Ndryshuar me Vendim Nr. 651, datë 31.10.2018, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 157, datë 07.11.2018)

5. Karakteristikat e pajisjes fiskale

Pajisja fiskale, nëpërmjet së cilës memorizohet qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve, duhet të ketë këto karakteristika:

- Programin e logjikës (Firmware), i cili është i mbrojtur nga ndryshimi dhe fshirja, duke përdorur funksionet standarde për regjistrimin e shifrave të mallrave e shërbimeve, printimin, shfaqjen në ekran dhe administrimin e të dhënave, të hyra në një memorie fiskale.
- Letrën shirit (më poshtë e referuar si kupon tatimor) që gjenerohet nga pajisja fiskale, e cila duhet të ketë të printuar logon fiskale, të përbërë prej stemës së Republikës së Shqipërisë, simboleve “RSH” (Republika e Shqipërisë) e “MF” (Ministria e Financave) dhe numrin e identifikimit të pajisjes fiskale, të cilat nënkuptojnë mbajtjen e regjistrimeve të xhiros, nëpërmjet pajisjes fiskale të autorizuar, sipas numrit të identifikimit në Republikën e Shqipërisë.
- Siguron leximin e xhiros së regjistruar, sipas ditës, muajit dhe vitit.
- Siguron leximin e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale dhe QSHKE.
- Siguron ruajtjen e të dhënave të regjistruara në memorien fiskale dhe regjistrimin e tyre në QSHKE.
- Siguron regjistrimin e xhiros mbi një kupon tatimor, që i jepet klientit.
- Siguron regjistrimin e vlerës reale të mallrave dhe/ose shërbimeve, nëpërmjet rrumbullakimit deri në dy shifra pas presjes dhjetore.
- Siguron kushte për kryerjen e provës, për arsye të kontrollit të saktësisë së pajisjes dhe memories fiskale, si dhe të funksionit në lidhje me të.
- Mundëson rifillimin e veprimeve, nga çasti i ndërprerjes, pas eliminimit të defekteve, me përjashtim të rasteve kur ka probleme të prishjes së memories fiskale.
- Ka memorie operacionale (RAM), ku jepen emërtimet e mallrave apo shërbimeve që janë futur, çmimi, mënyra e pagesës, paraqitja e hollësishme e shkallëve tatimore, të shënuar me shkronjat “A-I”, përqindja e taksës së zbatuar si dhe mundësinë për printimin e automatizuar të emërtimit të mallrave me çmimet dhe shkallët tatimore përkatëse, të futura më parë në memorien operacionale;
- Siguron mbylljen me një pikë të dukshme, me vulën fiskale, duke mos lejuar hapjen.
- Siguron mbrojtje fizike të informacionit të ruajtur në memorien fiskale.
- Siguron bllokimin e pajisjes fiskale, duke shfaqur mesazhin “Gabim” në qoftë se një nga pjesët etij funksionale është jashtë përdorimit, mungon apo nuk përmbush kushtet për kërkesat, teknike dhe funksionale.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

- Siguron futjen e të dhënave në memorien fiskale. Të dhënat nuk mund të jenë më të vjetra se data e regjistrimit të të dhënave paraprake në memorien fiskale, ndërsa të dhënat më të reja nuk mund të jenë më të vjetra se data për të cilën është përgatitur raporti tatimor ditor.
- Ndalon fshirjen e të dhënave të xhiros, për të cilën është bërë e mundur dalja e kuponit tatimor.
- Ndalon futjen e të dhënave të mëtejshme, në qoftë se të dhënat e futura nuk janë regjistruar njëkohësisht mbi shiritin e kuponit tatimor dhe QSHKE.
- Ndalon fshirjen e të dhënave nga memoria operative (RAM). Fshirja e të dhënave të memories operative lejohet vetëm duke hequr vulën fiskale nga tekniku i autorizuar sipas procedurave të miratuara me udhëzim nga Ministri i Financave dhe vetëm pasi të jetë kryer raporti tatimor ditor. Çdo fshirje e memories operative duhet të shoqërohet me regjistrimin e veprimit përmes rritjes së numrit të ndërhyrjeve teknike, e cila do të pasqyrohet në raportin tatimor ditor pasardhës. Tekniku i autorizuar rivendos vulën fiskale pas ndryshimeve të bëra dhe regjistron në librin e mirëmbajtjes procedurën e kryer.
- Ndalon ndryshimin e datës, orës së regjistrimit të xhiros dhe të të gjitha të dhënave të tjera, të regjistruara në memorien fiskale. Funkzioni i ndryshimit të orës reale lejohet vetëm brenda kufirit të vetëm +/- një orë, pas kryerjes së raportit tatimor ditor.
- Ndalon fshirjen e xhiros ditore, përpara kryerjes së raportit tatimor ditor.
- Ndalon printimin e kuponit tatimor dhe të raporteve tatimore në regjimin e trajnimit.
- Ndalon fshirjen e numërorit, numrin e kuponëve tatimorë, numrin e ndryshimeve të shkallëve tatimore, numrin e fshirjes së memories operative (RAM), numrin e ndryshimeve të adresës.
- Për çdo riprintim të kuponit tatimor, raportet në regjimin e leximit të programimit dhe raportet e leximit të QSHKE-së janë jotatimore. Çdo raport në këto regjime duhet të kenë të printuar fjalët "INFO JOTATIMORE".
- Përditësimi i programit logjik të pajisjes fiskale (Firmware) bëhet vetëm pasi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të ketë lejuar në mënyrë shkresore një procedurë të tillë, si dhe duke hequr vulën fiskale duke hapur pajisjen fiskale. Kjo procedurë shoqërohet me regjistrimin e veprimit përmes rritjes së numrit të ndërhyrjeve teknike, e cila do të pasqyrohet në raportin tatimor ditor pasardhës. Tekniku i autorizuar rivendos vulën fiskale pas ndryshimeve të bëra dhe regjistron në librin e mirëmbajtjes procedurën e kryer.
- Ka një sensor, i cili automatikisht ndalon regjistrimin e mëtejshëm të xhiros në mungesë të letrës së kuponit tatimor.
- Ndalon automatikisht regjistrimin e mëtejshëm të xhiros në mungesë të letrës ose QSHKE-së.
- Mund t'i ofrojë klientit të mallrave dhe shërbimeve monitorimin vizual të të dhënave të regjistruara nga operatori.
- Si opsion shtesë, mund të lidhet me një program aplikativ të instaluar në një kompjuter, i cili duhet t'i transmetojë të dhënat në pajisjet fiskale, në kohë reale për çdo artikull. Regjistrimi i artikullit pasardhës, në programin aplikativ të kompjuterit, do të bëhet pas konfirmimit të marrë nga pajisja fiskale për regjistrimin e artikullit paraardhës. Skema e lidhjes në këtë rast do të miratohet nga komisioni i caktuar për verifikimin e pajisjeve dhe sistemeve fiskale i parashikuar në nenin 13.1 të kreut I "Dispozita të përgjithshme".
- Siguron që pajisja fiskale ose transmetuesi i të dhënave (modemi) GPRS, i cili është i identifikueshëm dhe funksional vetëm për atë pajisje fiskale, është i pajisur me një modul elektronik kodifikues (crypto-chip) që gjeneron dhe menaxhon dy çelësa (1 privat dhe 1 publik) RSA asimetrik për të nënshkruar në mënyrë elektronike të dhënat e transferuara në server.
- Është e pajisur me një dokument, që këtu e më poshtë do të referohet si pasaporta teknike e pajisjes, në të cilin janë të identifikuar me numër serial unik të gjitha pjesët përbërëse të pajisjes fiskale.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

- Është e pajisur me një dokument që lëshohet nga një laborator ndërkombëtar i akreditur (i njohur nga sistemi ynë i akreditimit), i cili vërteton pas kryerjes së testit, të gjitha karakteristikat e përcaktuara më sipër dhe në përgjithësi në këtë vendim.

5.1 Memoria fiskale

Memoria fiskale ruan informacionin edhe në mungesë të furnizimit me energji elektrike (e tipit *nonvolatile*). Informacioni nuk mund të ndryshohet apo të fshihet, por vetëm të shkruhet dhe të lexohet. Memoria fiskale duhet të mbyllet si një modul, pjesë përbërëse e shasisë së pajisjes fiskale, duke e bërë pjesë të pandashme të saj. Memoria fiskale duhet të memorizojë të dhënat e regjistruara për një periudhe minimale kohore 5-vjeçare. Kapaciteti i memories fiskale duhet të sigurojë minimalisht ruajtjen e 1800 raporteve ditore fiskale.

- Memoria fiskale duhet të sigurojë jo më shumë se 20 ndryshime të shkallëve tatimore, 20 Ndryshime të adresës dhe jo më shumë se 200 ndërhyrje për zhblokime të programit logjik (Firmware).

Memoria fiskale paralajmëron rreth numrit të raporteve fiskale të mbetura (jo më pak se 50) dhe tregon numrin e mundshëm të këtyre raporteve të mbetura pas çdo raporti fiskal të regjistruar. Kur memoria fiskale është e mbushur (plot), pajisja fiskale nuk duhet të lejojë regjistrimin e mëtejshëm të xhiros. Zëvendësimi i memories fiskale do të bëhet nga shoqëria e autorizuar, vetëm pas autorizimit me shkrim të administratës tatimore dhe duke ndjekur procedurat e çregjistrimit dhe të regjistrimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale.

5.2 Qarku i shiritit të kontrollit elektronik (QSHKE)

Pajisja fiskale ka si qëllim të regjistrojë dhe të ruajë shitjet duke përdorur një mekanizëm për regjistrimin e qarkullimit i cili duhet të jetë i mbrojtur. Të dhënat duhet të regjistrohen në mënyrë të njëkohshme në një njësi memorieje si qarku i shiritit të kontrollit elektronik i cili vërtetëson dhe nuk lejon ndryshimet e informacionit.

5.2.1 QSHKE-ja është një memorie e zëvendësueshme e tipit “Flash”, e cila kontrollohet nga programi logjik i pajisjes fiskale (Firmware) dhe duhet të sigurojë nivele të mjaftueshme të garancisë fiskale.

5.2.2 Qarku i shiritit të kontrollit elektronik është i realizuar sipas këtyre karakteristikave bazë:

a) Duhet të garantojë paprekshmërinë dhe të mos të lejojë ndryshimin e informacionit të regjistruar;

b) Në mungesë ose në rast defekti të QSHKE-së, pajisja fiskale duhet të bllokohet;

c) QSHKE-së duhet t'i kalohet një informacion i nevojshëm elektronik, i cili lejon të krijojë një lidhje logjike midis të dhënave të memorizuara dhe memories fiskale dhe të shërbejë si një mënyrë verifikimi e kësaj memorieje fiskale, ku totalet e vlerave të regjistruara janë të njëjta.

5.2.3 QSHKE-ja duhet të kontrollohet drejtpërdrejt nga programi logjik fiskal i pajisjes fiskale.

5.2.4 Programi logjik fiskal i pajisjes fiskale (Firmware) kontrollon QSHKE-në dhe duhet të realizojë këto funksione:

a) Inicializimin e QSHKE-së në mënyrë që të garantojë lidhjen logjike të përshkruar në pikën 5.2.2, paragrafi “c”;

b) Leximin e QSHKE-së dhe printimin e përmbajtjeve të plota të tyre, të paktën: për datë, midis dy datave, për numër kupon, midis dy kuponëve. Mundësia e printimit duhet të jetë e lejuar edhe për QSHKE-në e përdorur më parë për atë pajisje fiskale.

c) Printimi i përmbajtjes së QSHKE-së duhet të kryhet sipas mënyrës së printimit të një kuponit administrimi jotatimor.

ç) Duhet të lajmërojë kur hapësira e memories së QSHKE-së është duke u mbushur.

d) Bllokimin e funksionimit të pajisjes fiskale në rast të mbushjes së QSHKE-së. Në këtë rast

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

duhet të jetë i lejueshëm vetëm një veprim, kryerja e raportit tatimor ditor në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi dhe inicializimi i një QSHKE-je të re.

dh) Në rast të situatave anormale, si mungesa e QSHKE-së, heqja ose zëvendësimi me një QSHKE të një pajisjeje tjetër, ose kur QSHKE-ja është e re/papërdorur, apo kur të dhënat e regjistruara nuk përputhen menjëherë, duhet të kryhet sinjalizimi i operatorit i shoqëruar me bllokimin e funksionimit të pajisjes fiskale.

e) Printimin e listës së QSHKE-së të inicializuara për atë pajisje fiskale. QSHKE-të e mbushura duhet të ruhen për 5 vjet.

ë) Para se të regjistrohet raporti tatimor ditor në memorien fiskale, duhet të krahasojë totalin e regjistruar në memorien operative me shumën totale të regjistruar në QSHKE për atë periudhë. Nëse totalet përputhen, liron memorien operative dhe regjistron këto vlera në memorjen fiskale ose bllokon pajisjen fiskale kur këto totale nuk janë të barabarta.

Ndalohet heqja dhe zëvendësimi i QSHKE-së me një të re nese kjo e fundit është e pambushur. Çdo QSHKE duhet të jetë e pajisur me një numër unik që pasqyrohet qartazi së bashku me kuponin e printuar nga regjistrimi themeltar, në pasaportën teknike të pajisjes fiskale dhe që e lidh me këtë të fundit.

5.3 Memoria operative

Memoria operative sipas pikës 5 të paragrafit 10 të këtij vendimi, ofron të dhënat për vlerat e mallrave të shitura dhe/ose të shërbimeve të paguara, të klasifikuara në ato, për të cilat është paguar TVSH-ja përkatëse dhe në ato të përjashtuara prej saj.

5.4 Programi logjik

Programi logjik i pajisjes fiskale (Firmware) është i ruajtur në një qark elektronik (EPROM) dhe lejon ndërveprimin me të gjitha pjesët përbërëse të këtyre pajisjeve. Lexon dhe shkruan në memorien fiskale, qarkun e shirit të kontrollit elektronik, përdor funksionet standarde për regjistrimin e shifrave të mallrave dhe shërbimeve, printimin, shfaqjen në ekran dhe administrimin e të dhënave të regjistruara në një memorie fiskale.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

6. Sistemi fiskal për tatimpaguesit në sektorë të veçantë

6.1 Sistemet fiskale për shoqëritë e hidrokarbureve me pakicë.

6.1.1 Sistemi fiskal i dispenserave të pikave të tregtimit me pakicë

Sistemi fiskal, i cili përdoret për shoqëritë e hidrokarbureve/të shitësve me pakicë, për regjistrimin e qarkullimit të shitjes/të transferimit me pakicë të derivateve të naftës, duke regjistruar llojin, sasinë dhe vlerën, është një sistem fizik (*hardware*), i përbërë nga këto elemente:

1. Pajisja fiskale, sipas pikës 2 të këtij vendimi;
2. Kontrolluesi i dispenserit elektronik (KDE);
3. Sistemi për monitorimin dhe kontrollin e rezervuarëve, të përcaktuar sipas pikës 6.1.2 të këtij vendimi;
4. Kontrolleri fiskal.

Sistemi fiskal, që do të zbatohet në pikat e tregtimit me pakicë, është sipas skemës:

- KDE dhe pajisje fiskale e instaluar në çdo dispenser të lidhur me kontrollerin fiskal;
- Sistemi për monitorimin dhe kontrollin e rezervuarëve të instaluar në çdo rezervuar të lidhur me kontrollerin fiskal;
- Kontrolleri fiskal, i lidhur në kohë reale me platformën e sistemeve fiskale në serverin qendror të DPT-së.

a) KDE-ja është pajisja që kontrollon e komandon qarkun elektronik të dispenserit dhe përpunon

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

e transferon të dhënat e shitjes në pajisjen fiskale. Të gjithë dispenserat punojnë vetëm në regjimin automatik. Konstrukti i KDE-së është i ndërtuar sipas të njëjtave standarde si pajisja fiskale, me një pikë hapeje, në të cilën do të vendoset vula fiskale, duke përfshirë edhe pikat e lidhjes të KDE-së.

KDE-ja ka një program logjik (*firmware*) fiskal me këto karakteristika:

- Në rast se dispenser kalon në regjimin manual, KDE-ja memorizon kohën e kalimit në regjimin manual dhe të gjithë shumatorët e dispenserit dhe ajo, bashkë me pajisjen fiskale, kalojnë në regjimin e bllokimit. Këto informacione transmetohen menjëherë nga kontrolleri fiskal në serverin qendror të DPT-së. Rivendosja në punë e sistemit fiskal kryhet me procedurë të veçantë, duke përdorur një kod kontrolli të veçantë, i lëshuar nga platforma e sistemeve fiskale në serverin qendror, sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në momentin e rivendosjes në punë, KDE-ja rilexon të gjithë shumatorët e dispenserit në momentin e kalimit automatik dhe këto të dhëna kontrolleri fiskal i transmeton në serverin qendror.

Nuk lejohet përdorimi i çfarëdolloj programi kompjuterik nga shoqëri të paautorizuara në transmetimin e të dhënave nga dispenserit në pajisjen fiskale.

- Në portën e komunikimit të dispenserit lidhet vetëm KDE-ja.

Furnizimi me karburant kryhet vetëm pas autorizimit nga pajisja fiskale dhe KDE-ja, sipas parimit “pa kupon, s’ka karburant”.

KDE-ja lidhet në mënyrë aktive vetëm me pajisjen fiskale dhe bllokun dispenserin, në rast shpërbërjeje me pajisjen.

Në rast se një dispenser është pa pajisje fiskale të instaluar, ai stacion tregtimi bllokohet dhe nuk lejohet të tregtojë derisa të instalohet pajisja fiskale apo të procedohet me çinstalimin fizik të tij.

Është e ndaluar lidhja e KDE-së me programe të tjera të paautorizuara, nga shoqëri të paautorizuara.

b) Kontrolleri fiskal është pajisja master, që kontrollon, komandon e përpunon të dhënat nga pajisjet fiskale dhe nga sistemet e monitorimit e të kontrollit të instaluar në rezervuare, sipas pikës 6.1.2 të këtij vendimi. Kontrolleri fiskal memorizon në bazën e të dhënave të tij dhe dërgon në kohë reale të dhënat në platformën e sistemeve fiskale në serverin qendror, pranë DPT-së.

Konstrukti i kontrollit fiskal është i ndërtuar sipas të njëjtave standarde si pajisja fiskale, me një pikë hapeje, në të cilën do të vendoset vula fiskale, duke përfshirë edhe pikat e lidhjes.

Hapja e kontrollit kryhet vetëm me autorizim nga serveri qendror i pajisjeve dhe sistemeve fiskale, nëpërmjet shkëmbimit të çelësave të sigurisë. Në rast hapeje të paautorizuar, kontrolleri bllokohet dhe nuk lejon funksionimin e të gjitha pajisjeve fiskale në atë pikë tregtimi. Zhblokimi kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Kontrolleri fiskal ka të integruar apo të lidhur një sistem GPS të pozicionimit global të pikës së tregtimit me pakicë.

Kontrolleri fiskal mund të ofrojë si opsion një ndërfaqe grafike për menaxhimin administrativ të pikës dhe mundësinë e krijimit të një rrjeti me zyrën qendrore të kompanisë së tregtimit me pakicë të hidrokarbureve. Kjo ndërfaqe është pjesë e sistemit fiskal.

Është i ndaluar përdorimi i çfarëdo programi menaxhimi që nuk është pjesë e sistemit fiskal apo është i pacertifikuar nga shoqëria e autorizuar.

Protokollet e komunikimit dhe forma logjike e funksionimit të këtij sistemi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6.1.2 Sistemi për monitorimin dhe kontrollin e hyrjeve dhe të daljeve në rezervuarët e pikave të tregtimit me pakicë

Ky sistem është një sistem fizik (*hardware*), i përbërë nga këto elemente:

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

1. Sondat;

2. Njësia qendrore e sondave (konsole).

Sonda është një mekanizëm që shërben për të matur nivelin dhe temperaturën në rezervuar.

Njësia qendrore e sondave (konsole), shërben për përpunimin dhe auditimin e të dhënave nga sondat.

Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve dhe të daljeve në rezervuarë kryen këto funksione:

- Mat vazhdimisht nivelin e karburantit brenda çdo rezervuari dhe e kthen atë në vëllimin përkatës të karburantit;

- Gjen rrjedhjet e karburantit;

- Njësia qendrore e sondave dërgon informacion në kontrollerin fiskal për rrjedhjet, gabimet njerëzore, dështimet HW apo programimet e rreme;

- Njësia qendrore e sondave memorizon të gjitha veprimet hyrëse në rezervuar, duke matur vëllimin përkatës të karburantit dhe të gjitha detajet e furnizimit i dërgohen kontrollit fiskal.

Këto të dhëna, kontrollit fiskal i memorizon në bazën e të dhënave të tij dhe i dërgon në kohë reale në platformën e sistemeve fiskale pranë DPT-së.

Kontrolleri fiskal monitoron dhe krahason sasitë në dalje të dispenserave, të regjistruara nga pajisjet fiskale, me sasitë përkatëse në dalje të rezervuarëve gjatë operimit të pikës së tregtimit me pakicë të karburantit, në kohë reale.

Në rast se sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve dhe të daljeve të rezervuarve shkëputet nga kontrolleri fiskal, sistemi fiskal bllokohet dhe kontrolleri fiskal dërgon menjëherë mesazhin e alarmit në serverin qendror të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në DPT. Zhbllokimi i tij kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në çdo rezervuar të pikës së tregtimit me pakicë instalohet sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve dhe të daljeve.

Në rast se në një rezervuar nuk janë instaluar sondat, ajo pikë e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve bllokohet derisa të instalohet sonda ose të procedohet mbyllja e tij.

Çdo rezervuar, para instalimit të sondave, kryen procedurën e kalibrimin elektronik.

Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve dhe të daljeve në rezervuar miratohet nga komisioni i caktuar për verifikimin e sistemit fiskal, i parashikuar në nenin 13.1, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”. Këto pajisje i nënshtrohen kontrollit periodik fiskal dhe të kalibrimin nga shoqëritë e autorizuar.

Protokollet e komunikimit dhe forma logjike e funksionimit të sistemit të monitorimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6.2 Sistemet fiskale për zonat e lira doganore, shoqëritë e prodhimit dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve

Çdo zonë e lirë doganore apo shoqëri që ka licencën e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve është e detyruar të instalojë në pikën e tregtimit sistemet fiskale të përcaktuar në pikat 6.2.1 dhe 6.2.2, të këtij vendimi. Subjekte të monitorimit fiskal janë të gjitha depozitat fikse apo lëvizëse të fluidit, të gjitha pusët e prodhimit dhe ekstremitetët e rrugëve të kalimit të fluidit. Sistemet fiskale të instaluar në zonat e lira doganore, të prodhimit apo të tregtimit me shumicë, do të përshtaten me sistemet fiskale të përcaktuara në këtë vendim dhe do të ricertifikohen nga shoqëritë e autorizuar nga komisioni i caktuar për verifikimin e sistemeve fiskale, i parashikuar në nenin 13.1, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”.

6.2.1 Sistemi fiskal për kalimatësit e shitjeve me shumicë të hidrokarbureve

Sistemi fiskal që zbatohet nga shoqëritë e hidrokarbureve/shitësve me shumicë, zonat e lira doganore dhe shoqëritë prodhuese të hidrokarbureve e të derivateve të tyre, i cili regjistron llojin, sasinë dhe vlerën, është një sistem fizik (*hardware*), i përbërë nga këto elemente:

1. Pajisja fiskale me KDE;

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

2. Kalimatësi me kokë elektronike;

3. Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të depozitave, sipas pikës 6.2.2 të këtij vendimi;

4. Kontrolleri fiskal.

Skema e lidhjes së sistemit fiskal, që zbatohet nga shoqëritë e hidrokarbureve/shitësve me shumicë, zonat e lira doganore dhe shoqëritë prodhuese të hidrokarbureve e të derivateve të tyre, është si më poshtë vijon:

- Koka elektronike e kalimatësit lidhet me KDE-në e pajisjes fiskale, e cila lidhet me kontrollerin fiskal;

- Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të depozitave lidhet me kontrollerin fiskal;

- Kontrolleri fiskal lidhet në kohë reale me platformën e menaxhimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në DPT.

Kontrolleri fiskal menaxhon informacionin nga pajisja fiskale, e cila është e lidhur me kokën elektronike të kalimatësit nëpërmjet KDE-së.

Këto të dhëna, pasi memorizohen në bazën e të dhënave të kontrollerit, krahasohen me të dhënat e sistemit të monitorimit e të kontrollit të depozitave. Ky informacion dërgohet në kohë reale nga kontrolleri fiskal në platformën e menaxhimit të pajisjeve e sistemeve fiskale në DPT.

Në rast se informacionet e marra nuk përputhen me njëra-tjetrën, sistemi bllokohet dhe dërgon informacionin në kohë reale në serverin qendror, në DPT. Zhblokimi i tij kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Konstrukt i kontrollerit fiskal është i ndërtuar sipas të njëjtave standarde, si pajisja fiskale, me një pikë hapjeje, në të cilën do të vendoset vula fiskale, duke përfshirë edhe pikat e lidhjes.

Hapja e kontrollerit kryhet vetëm me autorizim nga serveri qendror i pajisjeve dhe sistemeve fiskale, nëpërmjet shkëmbimit të çelësave të sigurisë. Në rast të hapjes së paautorizuar, kontrolleri bllokohet dhe nuk lejon funksionimin e të gjitha pajisjeve fiskale në atë pikë tregtimi. Zhblokimi kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Kontrolleri fiskal ka të integruar apo të lidhur një sistem GPS të pozicionimit global të pikës së tregtimit me shumicë.

Të gjitha pajisjet matëse, pjesë e sistemit fiskal, pasi të marrin miratimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, duhet të miratohen edhe në komisionin e certifikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i caktuar për verifikimin e sistemeve fiskale, sipas nenit 13.1, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, si pjesë e sistemit fiskal.

Këto pajisje i nënshtrohen kontrollit periodik fiskal dhe të kalibrimit nga shoqëritë e autorizuar.

Është i ndaluar përdorimi i çfarëdo programi që nuk është pjesë e sistemit fiskal apo i certifikuar nga shoqëria e autorizuar.

Protokollet e komunikimit dhe forma logjike e funksionimit të këtij sistemi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6.2.2 Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve e të daljeve në depozitat e pikave të shumicës.

Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve e të daljeve në depozitat e pikave të tregtimit me shumicë është një sistem fizik (*hardware*), i përbërë nga këto elemente:

1. Sondat;

2. Njësia qendrore e sondave (konsole);

3. Kontrolleri fiskal.

Sonda është një mekanizëm që shërben për të matur nivelin dhe temperaturën në depozita.

Njësia qendrore e sondave (konsole) shërben për përpunimin dhe për auditimin e të dhënave nga sondat.

Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të depozitave duhet të kryejë këto funksione:

- Të masë vazhdimisht nivelin e karburantit brenda çdo depozite dhe ta kthejë atë në vëllimin

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

përkatës të karburantit;

- Njësia qendrore e sondave duhet të dërgojë informacion në kontrollerin fiskal për rrjedhjet, gabimet njerëzore, dështimet HW apo programimet e rreme.

- Njësia qendrore e sondave memorizon të gjitha veprimet hyrëse në rezervuar, duke matur vëllimin përkatës të karburantit dhe të gjitha detajet e furnizimit i dërgohen kontrollërit fiskal.

Këto të dhëna kontrollërit fiskal i memorizon në bazën e të dhënave të tij dhe i dërgon në kohë reale në serverin qendror të pajisjeve dhe sistemeve fiskale pranë DPT-së.

Kontrollëri fiskal monitoron dhe krahason sasi të dalje të kalimatësve, të regjistruara nga pajisjet fiskale, me sasi të përkatëse në dalje nga depozitat, gjatë operimit të pikës së tregtimit me shumicë në kohë reale.

Në rast se sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve e të daljeve të depozitave shkëputet nga kontrollëri fiskal, sistemi fiskal bllokohet dhe dërgon menjëherë mesazhin e alarmit në serverin qendror të pajisjeve e sistemeve fiskale në DPT. Zhblokimi i tij kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në çdo depozitë të pikës së tregtimit me shumicë do të instalohen sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve e të daljeve. Në rast se në një depozitë nuk është instaluar ky sistem sonde, ajo pikë e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve bllokohet derisa në atë depozitë të instalohet sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve e daljeve ose të procedohet me bllokimin fizik të tij.

Sistemi i monitorimit dhe i kontrollit të hyrjeve e daljeve në depozita, pasi të marrë miratimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, miratohet nga komisioni i caktuar për verifikimin e sistemit fiskal, i parashikuar në nenin 13.1, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”. Këto pajisje i nënshtrohen kontrollit periodik fiskal dhe të kalibrimit nga shoqëritë e autorizuar.

Protokollet e komunikimit dhe forma logjike e funksionimit të këtij sistemi do të përgatitet sipas udhëzimit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6.3 Sistemi fiskal për pikat e tregtimit me pakicë të bombolave të GLN-së në njësitë e lëndëve djegëse

Sistemi fiskal që do të zbatohet nga shoqëritë e tregtimit me pakicë të bombolave të GLN-së në njësitë e lëndëve djegëse, duke regjistruar llojin, sasinë në kg dhe vlerën, është një sistem fizik (*hardware*), i përbërë nga këto elemente:

1. Pajisja fiskale me KDE;

2. Sonda për monitorimin dhe kontrollin e GNL-së, e instaluar në depozita;

3. Kontrollëri fiskal.

Skema e lidhjes së sistemit fiskal, që do të zbatohet nga shoqëritë e tregtimit me pakicë të bombolave të GLN-së në njësitë e lëndëve djegëse, është si më poshtë vijon:

- KDE-ja e pajisjes fiskale instalohet në dispenserin GNL ose në kokën elektronike të kalimatësit, që lidhet me kontrollërin fiskal;

- Sondat për monitorimin dhe për kontrollin e depozitës lidhen me kontrollërin fiskal;

- Kontrollëri fiskal është i lidhur në kohë reale me platformën e menaxhimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në DPT.

Në çdo linjë të furnizimit të bombolave në njësinë e lëndëve djegëse do të instalohet dispenser GNL ose kalimatës me kokë elektronike.

Dispenseri do të punojë vetëm në regjimin automatik.

Kontrollëri fiskal menaxhon informacionin nga pajisja fiskale, e cila është e lidhur me dispenserin e GNL-së ose kokën elektronike të kalimatësit, nëpërmjet KDE-së. Këto të dhëna, pasi memorizohen në bazën e të dhënave të kontrollërit, krahasohen me të dhënat e sondave të monitorimit e të kontrollit të depozitave.

Ky informacion dërgohet në kohë reale nga kontrollëri fiskal në platformën e menaxhimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në DPT.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

Në rast se informacionet e marra nuk përputhen me njëra-tjetrën, sistemi bllokohet dhe dërgon informacionin në kohë reale në serverin qendror në DPT. Zhbllokimi i tij kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Konstrukti i kontrollit fiskal është i ndërtuar sipas të njëjtave standarde si pajisja fiskale, me një pikë hapjeje, në të cilën do të vendoset vula fiskale, duke përfshirë edhe pikat e lidhjes.

Hapja e kontrollit kryhet vetëm me autorizim nga serveri qendror i pajisjeve dhe i sistemeve fiskale, nëpërmjet shkëmbimit të çelësave të sigurisë. Në rast hapjeje të paautorizuar, kontrolleri bllokohet dhe nuk lejon funksionimin e gjitha pajisjeve fiskale në atë pikë tregtimi. Zhbllokimi kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Kontrolleri fiskal ka të integruar apo të lidhur një sistem GPS të pozicionimit global të pikës së tregtimit me pakicë të bombolave të GLN-së në njësitë e lëndëve djegëse.

Të gjitha pajisjet matëse, pjesë e sistemit fiskal, pasi të marrin miratimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, duhet të miratohen edhe në komisionin e certifikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i caktuar për verifikimin e sistemeve fiskale sipas parashikimeve në nenin 13.1, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, si pjesë e sistemit fiskal. Këto pajisje i nënshtrohen kontrollit periodik fiskal dhe të kalibrit nga shoqëritë e autorizuar.

Protokollet e komunikimit dhe forma logjike e funksionimit të këtij sistemi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6.4 Sistemi fiskal për pikat e furnizimit me shumicë dhe zonat e lira doganore të gazit të lëngshëm
Sistemi fiskal që do të zbatohet nga shoqëritë e furnizimit me shumicë të gazit të lëngshëm dhe zonat e lira doganore, duke regjistruar llojin, sasinë në kg dhe vlerën, është një sistem fizik (*hardware*), i përbërë nga këto elemente:

1. Pajisja fiskale me KDE;
2. Sonda për monitorimin dhe kontrollin e GNL-së, e instaluar në depozita;
3. Kontrolleri fiskal.

Skema e lidhjes së sistemit fiskal, që do të zbatohet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm, është si më poshtë vijon:

- KDE-ja e pajisjes fiskale, e instaluar në kokën elektronike të kalimatësit, lidhet me kontrollerin fiskal;
- Sondat për monitorimin dhe kontrollin e depozitës lidhen me kontrollerin fiskal;
- Kontrolleri fiskal, i lidhur në kohë reale me platformën e menaxhimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në DPT.

Në çdo linjë të tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm do të instalohet kalimatës me kokë elektronike.

Kontrolleri fiskal menaxhon informacionin nga pajisja fiskale, e cila është e lidhur me kokën elektronike të kalimatësit nëpërmjet KDE-së. Këto të dhëna, pasi memorizohen në bazën e të dhënave të kontrollit, krahasohen me të dhënat e sondat e monitorimit e të kontrollit të depozitave. Ky informacion dërgohet në kohë reale nga kontrolleri fiskal në platformën e menaxhimit të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në DPT.

- Në rast se informacionet e marra nuk përputhen me njëra-tjetrën, sistemi bllokohet dhe dërgon informacionin në kohë reale në serverin qendror në DPT. Zhbllokimi i tij kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Konstrukti i kontrollit fiskal është i ndërtuar sipas të njëjtave standarde si pajisja fiskale, me një pikë hapjeje, në të cilën do të vendoset vula fiskale, duke përfshirë edhe pikat e lidhjes.

- Hapja e kontrollit kryhet vetëm me autorizim nga serveri qendror i pajisjeve dhe i sistemeve fiskale, nëpërmjet shkëmbimit të çelësave të sigurisë. Në rast hapjeje të paautorizuar, kontrolleri bllokohet dhe nuk lejon funksionimin e të gjitha pajisjeve fiskale në atë pikë tregtimi. Zhbllokimi kryhet sipas procedurës së përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

Të gjitha pajisjet matëse, pjesë e sistemit fiskal, pasi të marrin miratimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, duhet të miratohen edhe në komisionin e certifikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i caktuar për verifikimin e sistemeve fiskale, sipas parashikimeve në nenin 13.1, të kreut I, "Dispozita të përgjithshme", si pjesë e sistemit fiskal. Këto pajisje i nënshtrohen kontrollit periodik fiskal dhe të kalibrit nga shoqëritë e autorizuar.

Protokollet e komunikimit dhe forma logjike e funksionimit të këtij sistemi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Kontrolleri fiskal ka të integruar apo të lidhur një sistem GPS të pozicionimit global të pikës së tregtimit me shumicë të gazit lëngshëm.

7. Pajisjet shitesë

7.1 Një pajisje fiskale mund të ketë pajisje shitesë, si: lexues barkod-esh(skaner), terminal për pagesa me karta krediti/debiti, peshore dhe të tjera që mund të përcaktohen me udhëzimet përkatëse.

7.2 Pajisja fiskale me një terminal të integruar për pagesën me kartë krediti/debiti duhet të jetë në përputhje me standardet e kërkuara sipas udhëzimeve përkatëse.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

8. Procedurat për pajisjen fiskale

8.1 Regjistrimi i të dhënave themeltare në memorien fiskale

8.1.1 Përpara se të fillojë hedhja e të dhënave të qarkullimit, nëpërmjet pajisjes fiskale në memorien fiskale, paraprakisht ato duhet të regjistrohen nga shoqëritë e autorizuar. Kjo procedurë kryhet me pajisje të hapur dhe vetëm në këtë rast moduli elektronik crypto-chip krijon 2 çelësat RSA asimetrik, çelësin privat e memorizon në chip-in e tij, me anë të të cilit do të gjenerojë firmën elektronike në raportet tatimore ditore dhe atë publik me anë të të cilit server qendror do të dekriptojë informacionin për të vërtetësuar firmën elektronike. Këtë çelës dhe bashkë me të dhënat që do të hidhen në këtë procedurë, pajisja fiskale e dërgon përmes rrjetit të komunikimit GPRS në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Të dhënat që do të regjistrohen dhe do të dërgohen janë si më poshtë vijon:

a) numri i identifikimit të tatimpaguesit;

b) emri, adresa ku është instaluar pajisja fiskale;

c) numri i identifikimit të pajisjes fiskale (ky numër është i përbërë nga dy shkronja për identifikimin e shoqërisë së autorizuar, 2 shifra për identifikimin e autorizimit për t'u hedhur në treg të pajisjes fiskale dhe 6 numra të tjerë);

ç) data, ora dhe minuta e fillimit të mbajtjes së regjistrimit të xhiros;

d) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);

dh) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);

e) çelësi RSA publik;

ë) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën e regjistrimit të pajisjes fiskale. Pas dërgimit të të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me të dhënat si më sipër. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe bashkëngjijt kuponin e printuar në librin e mirëmbajtjes.

8.1.2 Nuk lejohet ndryshimi i të dhënave të pikës 8.1.1.

Nëse memoria fiskale pëson defekt, pajisja fiskale duhet të regjistrojë "Gabim" dhe të bllokohet.

8.2 Transferimi i pajisjes fiskale brenda të njëjtit subjekt

Transferimi do të bëhet pas miratimit me shkrim nga administrata tatimore dhe kjo procedure kryhet nga tekniku i autorizuar. Ndryshimi i adresës është i mundur të bëhet vetëm pasi të jetë kryer raporti tatimor ditor me pajisje fiskale të hapura. Këto ndryshime do të pasqyrohen në

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

rritjen e numrit të ndryshimeve të adresës, si dhe në raportin tatimor ditor pasardhës. Të dhënat e ndryshuara që do të dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit të komunikimit GPRS janë si më poshtë vijon:

- a) numri identifikimit të tatimpaguesit;
- b) emri dhe adresa e re;
- c) numri i identifikimit të pajisjes fiskale;
- ç) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);
- d) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);
- dh) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën;
- e) numërori i ndryshimit të adresës.

Pas dërgimit të këtyre të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me këto të dhëna. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe ia bashkëngjijt kuponin e printuar këtij libri.

8.3 Përfundimi i veprimtarisë së biznesit dhe çregjistrimi i pajisjes fiskale

8.3.1 Në rastin e përfundimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë administratën tatimore dhe shërbimin e mirëmbajtjes së shoqërisë së autorizuar, brenda tri ditëve

nga dita e përfundimit të kësaj veprimtarie. Tekniku i autorizuar kryen procedurën e çregjistrimit me pajisje të hapur. Të gjitha të dhënat e memories fiskale që dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit GPRS janë si më poshtë vijon:

- a) numri i identifikimit të tatimpaguesit;
- b) emri, adresa ku është instaluar pajisja fiskale;
- c) numri i identifikimit të pajisjes;
- ç) data, ora dhe minuta e mbarimit të regjistrimit të xhiros;
- d) numri i identifikimit të transmetuesit të të dhënave (IMEI);
- dh) numri i identifikimit të kartës SIM (IMSI);
- e) totalet e memories fiskale;
- ë) totalet e shkallëve tatimore;
- f) numërori i raporteve tatimore ditore;
- g) numërori i kuponëve tatimore;
- gj) numërori i ndërhyrjeve teknike;
- h) numërori i ndryshimeve të shkallës tatimore;
- i) numërori i ndryshimeve të adresës;
- j) kodi i teknikut të autorizuar që po kryen procedurën e çregjistrimit të pajisjes fiskale;
- k) firma elektronike.

Pas dërgimit të të dhënave, pajisja fiskale printon një kupon me këto dhëna. Tekniku i autorizuar plotëson librin e mirëmbajtjes së pajisjes fiskale dhe ia bashkëngjijt kuponin e printuar këtij libri.

8.3.2 Shoqëria e autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, kryen procedurën e çregjistrimit pasi administrata tatimore ta ketë miratuar, dhe ruan memorien fiskale, sipas pikës 8.3.1 të këtij vendimi.

8.3.3 Shoqëria e autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, ruan memorien fiskale, sipas pikave 8.3.1 dhe 8.3.2 të këtij vendimi, deri kur dega e tatimeve miraton, me shkrim, shkatërrimin e saj, në prani të një komisioni të përbërë nga punonjësit e shoqërisë së autorizuar të mirëmbajtjes dhe punonjësve të degës së tatimeve.

Dispozitat e paragrafëve të kësaj pike do të zbatohen edhe për ndryshimin e memories fiskale apo të pajisjes fiskale në rast defekti.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, dt. 17.02.2010, FI.Z. Nr. 24, dt.19 mars 2010).

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

8.4. Kontrolli periodik

Shoqëria e autorizuar, një herë në 24 (njëzet e katër) muaj, është e detyruar të kryejë kontrollin periodik teknik të pajisjeve dhe sistemeve fiskale. Tarifa e paguar për kontrollin periodik përfshin dhe tarifën e transmetimit, me nivel tavan jo më shumë se 4000 (katër mijë) lekë.

Tatimpaguesi siguron aksesin për kryerjen e kontrollit nga stafi teknik i kompanisë së autorizuar. Ngarkohet administrata tatimore të kontrollojë zbatimin e dhënies së shërbimit sipas këtij vendimi.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 126, dt. 13.2.2013, FI.Z. nr. 26, dt. 7.03.2013).

9. Procedurat e raportimit dhe të printimit

9.1 Raportimi periodik dhe afati

Pajisja fiskale dërgon në mënyrë automatike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dhënat fiskale ditore mbas mbylljes së raportit tatimor ditor.

Në rastet kur transmetimi nuk realizohet, pajisja fiskale i ridërgon raportet tatimore ditore të patransmetuara në mbylljen e raportit tatimor ditor të ardhshëm.

Për transmetim të dhënash pas këtij afati aplikohen penaltetet e përcaktuara në nenin 113 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

9.1.1 Të dhënat e referuara në raportin e qarkullimit të mallrave e shërbimeve ruhen në memorien fiskale.

Raporti periodik përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e raporteve;
- b) emrin dhe adresën e tatimpaguesit;
- c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit (NIPT-i);
- ç) numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;
- d) logon fiskale;
- dh) ditën, muajin, vitin, orën dhe minutën e përgatitjes së raportit;
- e) vlerën e qarkullimit total të mallrave dhe të shërbimeve;
- ë) vlerën e qarkullimit, sipas shkallës tatimore dhe/ose të përjashtimeve tatimore;
- f) shumën e tatimeve sipas shkallëve tatimore;
- g) numrin e kuponëve tatimorë, të emetuar të shiritit të pajisjes fiskale;
- gj) numrin e raportit të parë dhe të fundit në ditën e caktuar.

Në rastet e sistemeve fiskale sipas pikës 2.2, të dhënat e raportit periodik përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

9.2 Të dhënat e kuponit tatimor

9.2.1 Kuponi tatimor, që i jepet një blerësi apo një klienti, përmban këto të dhëna:

- a) emrin, adresën e tatimpaguesit dhe adresën e vendndodhjes së biznesit;
- b) NIPT-in;
- c) numrin e identifikimit të regjistruarit elektronik;
- ç) logon fiskale;
- d) numrin rendor të kuponit, datën dhe kohën;
- dh) emrin, sasinë, çmimin dhe vlerën e qarkullimit të regjistruar të mallrave dhe/ose të shërbimeve;
- e) shumën e TVSH-së, sipas shkallës tatimore;
- ë) vlerën e mallrave apo shërbimeve të shitura, të përjashtuara nga TVSH-ja;
- f) mënyrën e pagesës (cash, çek, kartë krediti etj.).

Në rastet e sistemeve fiskale sipas pikës 2.2, të dhënat e kuponit tatimor përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

9.2.2 Kuponi tatimor mund të reklamojë edhe të dhëna të tjera të cilat duhet të ruhen edhe në QSHKE.

9.2.3 Përjashtohen nga detyrimi i lëshimit të kuponit tatimor:

- a) tatimpaguesit, që paguajnë tatime mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarive për shuma të vogla të të ardhurave neto, me përjashtim të shoferëve të takside;
- b) personat, që nuk janë tregtarë dhe e realizojnë qarkullimin e produkteve bujqësore dhe të papërpunuara mbi tezgja, në tregjet e organizuara, si dhe jashtë merkatove;
- c) individët, që lëshojnë me qira mjedise biznesi;
- ç) veprimtaritë, të cilat ushtrohen në zona të larta malore, me popullim më pak se 300 individë dhe që janë të ndryshme nga vendet turistike.

9.3 Të dhënat e printuara

9.3.1 Të dhënat e printuara mbi kuponin tatimor duhet të jenë identike me të dhënat në qarkun e shiritit të kontrollit elektronik (QSHKE).

9.3.2 Printimi i të dhënave mbi kuponin tatimor dhe shkrimi i tyre në shiritin e kontrollit elektronik duhet të jetë në të njëjtën kohë.

9.3.3 Tregimi i të dhënave mbi shiritin e kontrollit elektronik dhe në memorien fiskale nuk duhet të bëhet nëpërmjet përdorimit të shkurtimeve të kodifikuara.

9.4 Printimi i të dhënave

Printimi i të dhënave duhet të kryhet në shiritin (letrën) e pajisjes elektronike fiskale e cila ruan të dhënat së paku për 5 vjet dhe që ka karakteristikat e përcaktuara në udhëzimet e Ministrit e Financave.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

10. Gabimet

Gabimet (error) e ndodhura gjatë mbajtjes së regjistrimeve të qarkullimit (gjatë shtypjes, këmbimit të mallrave etj.), mund të eliminohen para nxjerrjes së kuponit tatimor. Eliminimi i defektit "Gabim" duhet të regjistrohet mbi kuponin tatimor, nëpërmjet anulimit të shënuar me "-" (Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

11. Libri i raporteve dhe mirëmbajtjes

11.1 Tatimpaguesit mbajnë dhe ruajnë librin e raporteve ditore, i cili kontrollohet nga administrata tatimore. Raportet ditore futen në librin e raporteve ditore, i cili mbahet në ndërtesën, ku është edhe pajisja fiskale.

11.2 Format i dhe përmbajtja e librit të raportit ditor përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

11.3 Çdo pajisje fiskale duhet të jetë e pajisur nga shoqëria e autorizuar me një libër të posaçëm me numër faqesh të deklaruar dhe të numëruar në mënyrë progresive, në të cilën të paraqitet informacionet si më poshtë vijon:

- a) Emri, adresa, NIPT-i i shoqërisë së autorizuar;
- b) Të dhënat e certifikimit dhe të autorizimit për shitje të modelit të pajisjes fiskale;
- c) Numri i identifikimit të pajisjes fiskale;
- ç) Numri i faqeve të librit.

Në libër do të regjistrohet data, ora dhe vendi i instalimit dhe fiskalizimit të pajisjes fiskale, si dhe të regjistrohen të gjitha të dhënat e teknikut të autorizuar nga shoqëria e autorizuar, përfshirë vulën e identifikimit të tij. Në libër do të shënohen të gjitha ndërhyrjet e mirëmbajtjes teknike dhe të kontrollit teknik periodik.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

12. Mosfunksionimi i përkohshëm i pajisjes fiskale

Në rastet e parregullsive apo të mirëmbajtjes së pajisjes fiskale, mbajtja e regjistrimeve të qarkullimit realizohet në mënyrën dhe formën e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Mosfunksionimi i përkohshëm i pajisjes fiskale duhet të pasqyrohet dhe të provohet në librin e mirëmbajtjes, ku tekniku i shoqërisë së autorizuar regjistron kohën, kur pajisja është riparuar. (Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

13. Certifikimi i pajisjeve fiskale

13.1 Shoqëritë e autorizuar për furnizimin me pajisje apo sisteme fiskale janë të detyruara të certifikojnë llojet që do të hedhin në treg, në laboratorë ndërkombëtarë/shqiptarë të certifikuar, njohur nga sistemi akreditues shqiptar.

Pajisjet dhe sistemet fiskale, përfshirë dhe skemën e lidhjes, para se të vihen në zbatim, miratohen nga komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave. Komisioni kryen verifikimin, kontrollin e dokumentacionit të certifikimit të tyre, të mënyrës së lidhjes dhe, në përgjithësi, përputhshmërinë e sistemit me kërkesat e këtij vendimi.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të paraqitur nga shoqëritë, komisioni merr vendim për autorizimin ose jo të shoqërive për t'i lejuar për tregtimin e këtyre pajisjeve.

Ky komision përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, AKSHI, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe, sipas rastit, nga përfaqësues të ministrive të linjës, apo të institucioneve të tjera, për të cilat gjykohet se kanë lidhje me veprimtarinë që do të kryhet.

13.2 Shoqëritë e autorizuar për furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale duhet të sigurojnë stafin teknik për mirëmbajtjen e tyre. Gjatë mirëmbajtjes, teknikët e shoqërive të autorizuar mbajnë procesverbal, në dy kopje, ku pasqyrohen të dhënat rreth tatimpaguesit, i cili ka pasur ankesa për parregullsi të pajisjeve fiskale. Procesverbalet i bashkëngjiten librit të mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e pajisjes fiskale, përfshirë edhe mirëmbajtjen e memories fiskale, nuk duhet të zgjasë më shumë se dy ditë nga data e paraqitjes së ankesës për parregullsi.

13.3 Nëse vula e pajisjes fiskale duhet të hiqet gjatë procesit të mirëmbajtjes, vula e re pas mirëmbajtjes vendoset në praninë e përfaqësuesve të degës së tatimeve.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

14. Ndërhyrjet e paautorizuara në pajisjen fiskale

Heqja e paautorizuar e vulave dhe/ose ndërhyrja në çdo lloj forme tjetër në një apo disa komponentë të pajisjes fiskale dhe/ose të pjesëve që janë pjesë e lidhjes dhe funksionimit të sistemit fiskal në përgjithësi, konsiderohet si ndryshimi apo ndërhyrje në aparatet dhe arkat matëse regjistruese e të lëshimit të kuponëve, dhe personat që kanë bërë apo lejuar të bëjnë këto ndryshime, përveç përgjegjësisë penale, detyrohen t'i shpërblejnë administratës tatimore dëmin e shkaktuar nga këto ndërhyrje.

Nëse stafi teknik i shoqërive të autorizuar për furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, gjatë kontrollit teknik vëren se tatimpaguesi ka kryer veprime për ndryshimin e të dhënave të qarkullimit të regjistruar, shoqëria e autorizuar është e detyruar të informojë menjëherë organin tatimor.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010)

15. Procedura e instalimit të pajisjes fiskale

15.1 Tatimpaguesi aplikon për pajisje apo sistem fiskal pranë shoqërive të autorizuar.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

Shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të pajisin tatimpaguesin me sistem apo pajisje fiskale brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Shoqëritë e autorizuar kryejnë regjistrimin e të dhënave themeltare sipas pikës 8.1.2 të këtij vendimi.

Vulosja e pajisjes fiskale bëhet nga përfaqësuesi i shoqërisë së autorizuar, në prani të përfaqësuesve të degës së tatimeve.

Vula e pajisjes fiskale është unike dhe shënohet me një goditës (puncon) që ka të sigluar shenjat e vulës së identifikimit të teknikut të autorizuar.

15.2 Degët e tatimeve mbajnë regjistrime rreth pajisjes fiskale, nëpërmjet të cilave regjistrohet qarkullimi i tatimpaguesve. Format, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrimeve, sipas paragrafit të mësipërm, përcaktohen në këtë vendim. Mbajtja e regjistrimeve të xhiros, nëpërmjet pajisjes fiskale, nuk duhet të kryhet përpara vulosjes së pajisjes fiskale.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, dt. 17.02.2010, FI.Z. Nr. 24, dt.19 mars 2010).

II. Procedura e aplikimit dhe e autorizimit të shoqërive të autorizuar

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose i huaj, i organizuar si shoqëri aksionare, që kërkon të pajiset me autorizimin “Shoqëri e autorizuar” për furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën me shkrim për konkurrim për marrjen e autorizimit si “shoqëri e autorizuar”;

b) Deklaratën e plotësimit të të gjitha kërkesave ligjore të karakteristikave dhe funksionaliteteve për pajisjet të cilat do të tregtohen nga kjo shoqëri;

c) Aktin e themelimit të shoqërisë dhe statutin e shoqërisë;

ç) Vendimin për regjistrimin si person juridik;

d) Ekstrat të regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

dh) Dokumentet për kapacitetet organizative dhe administrative, si më poshtë vijon:

i) Deklaratë për fuqinë mesatare punëtore dhe për numrin e stafit drejtues deri në 3 (tri) vitet e fundit;

ii) Deklaratë për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

e) Listën e veprimtarive në bazë të të cilave ushtron veprimtarinë. Aplikuesi ose, nëse është bashkim operatorësh, të paktën anëtar i kryesues, duhet të ketë përvojë në fushën e teknologjisë, të paktën në 3 (tri) vitet e fundit të veprimtarisë së tij, për të cilën paraqet listën e sipërpërmendur.

ë) Pasqyrat financiare të audituara, të certifikuara nga ekspert (ë) kontabël, për 3 (tri) vitet e plota financiare të fundit, aty ku është e mundur, përfshirë bilanci e konsoliduara, pasqyrat e të ardhurave, pasqyrat e qarkullimit të parasë dhe shënimet shoqëruese për aksionarët e tij ose nëse aplikuesi është një bashkim shoqëri, për të gjithë aksionarët e anëtarëve të tij.

f) Qarkullimin vjetor për 3 (tri) vitet e fundit në total i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 10 milionë euro ose ekuivalente;

g) Burimet e financimit të projektit;

gj) Vetëdeklarimin nga aksionarët e tij dhe anëtarët e organeve drejtuese, që vërteton se nuk është në ndjekje penale, si dhe:

i) një dokument që vërteton se aplikanti nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

ii) një dokument që vërteton se aplikanti i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore, jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

iii) një dokument që vërteton se aplikanti i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore, jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës. Personat juridikë të huaj, që aplikojnë për të marrë autorizimin si “Shoqëri e autorizuar”, duhet të paraqesin dokumentet ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, në varësi të legjislacionit të vendit ku personi i huaj është regjistruar.

Aplikanti duhet t'i bashkëlidhë dosjes së aplikimit mandatarkëtimin e pagesës së tarifës së shërbimit, në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë, në llogarinë e Ministrisë së Financave. Dokumentet dorëzohen në protokollin e Ministrisë së Financave. Aplikantit i kthehen ato për plotësim, në qoftë se mungon qoftë edhe një nga dokumentet e sipërpërmendura.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

2.a) Ministria e Financave bën shpalljen e konkurrimit për pajisjen me autorizimin “Shoqëri e autorizuar” për furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale. Shpallja bëhet në 2 gazetatat vendase, me tirazh më të madh, dhe në një gazetë ndërkombëtare. Aplikanti i nënshtrohet procedurës së mëposhtme të konkurrimit, sipas afateve kohore të përcaktuara nga Ministria e Financave.

Kriteret për përzgjedhjen e aplikantëve për “Shoqëri të autorizuar” përcaktohen me urdhër të Ministrit të Financave.

b) Pranë Ministrisë së Financave ngrihet Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Aplikimeve për Shoqëri të Autorizuar. Komisioni miratohet nga Ministri i Financave dhe përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, dhe sipas rastit, nga përfaqësues të ministrisë së linjës apo të institucioneve të tjera, të cilët gjykohen se kanë lidhje me veprimtarinë që do të kryhet nga shoqëria. Për çdo dosje të trajtuar, anëtarët e komisionit shpërblehen me shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

Aplikantit i kthehen dokumentet për plotësim, në qoftë se mungon qoftë edhe një nga dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi. Aplikanti, brenda 7 (shtatë) ditëve, duhet të paraqesë në protokollin e Ministrisë së Financave dokumentet plotësuese. Nëse dokumentet e kërkuara janë të plota dhe në formën e parashikuar nga ky vendim, Komisioni vendos pranimin e aplikimit dhe brenda një periudhe kohore 7 (shtatë)-ditore kryen shqyrtimin e dosjes. Pas shqyrtimit të dosjes së aplikantit, Komisioni cakton datën e demonstrimit të pajisjeve fiskale dhe njofton tre ditë para aplikantit/ët.

Komisioni vlerëson çdo dosje dhe demonstrimin e aplikantit/ëve, në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative, që i jepet çdo kriteri të parashikuar në urdhrin e Ministrit të Financave dhe përzgjedh e shpall fituesin/t. Komisioni i propozon Ministrit të Financave dhënien e autorizimit si “Shoqëri e autorizuar” aplikantit/ëve fitues.

3. Forma dhe përmbajtja e autorizimit të shoqërisë së autorizuar miratohen nga Ministri i Financave. Në autorizim përcaktohen:

a) numri i regjistrimit;

b) emri i shoqërisë;

c) zonat detyruese me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) veprimtaritë kryesore që do të zhvillohen nga shoqëria e autorizuar;

d) data e lëshimit;

dh) kohëzgjatja e autorizimit për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rinovimi për një periudhë pesëvjeçare.

Autorizimi nënshkruhet nga Ministri i Financave dhe shoqërohet me kontratën e lidhur ndërmjet

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

Ministrisë së Financave dhe shoqërisë së autorizuar, ku specifikohen të drejtat dhe detyrimet që do të kenë palët respektive. Autorizimi hartohet në 3 (tri) kopje dhe regjistrohet në regjistrin e autorizimeve që mbahet në Ministrinë e Financave.

Shoqëritë e autorizuar për furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale duhet të plotësojnë të paktën këto kushte:

i) të depozitojnë një garanci bankare, në vlerën prej 500 000 (pesëqind mijë)\$, në llogari të Ministrisë së Financave;

ii) të sigurojnë pjesë këmbimi, shërbim dhe asistencë teknike;

iii) të kenë të paktën 3 (tri) qendra shërbimi në Republikën e Shqipërisë;

iv) Të sigurojnë të paktën një shërbim mirëmbajtjeje gjatë vitit të parë për pajisje të shitura pa kosto ekstra.

v) Të sigurojnë riparim apo zëvendësim të pajisjeve fiskale brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) orëve nga çasti kur përdoruesi i pajisjes ka kërkuar ndërhyrjen;

vi) Të kenë të punësuar, të paktën, një teknik për jo më shumë se 1000 (një mijë) pajisje fiskale. Në rast se “Shoqëria e autorizuar” nuk plotëson njërin nga këto kushte, i pezullohet autorizimi për një periudhë pesëmujore.

Monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe shoqërive të autorizuar kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 722 dt. 01.09.2010, FI.Z. Nr. 130, dt. 27 shtator 2010).

4. Forma dhe përmbajtja e autorizimit të shoqërisë së autorizuar miratohet nga Ministri i Financave.

4.1 Autorizimi përmban:

a) numrin e regjistrimit;

b) emrin e shoqërisë;

c) kufijtë e zonës;

ç) veprimtaritë kryesore, që do të zhvillohen nga shoqëria e autorizuar, si importi i pajisjeve fiskale, ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale apo të dy veprimtaritë.

d) datën e lëshimit;

dh) kohëzgjatjen e autorizimit.

4.2 Shoqëritë e autorizuar për shitjen apo dhënien me qira të pajisjeve fiskale duhet të plotësojnë të paktën, këto kushte:

a) të depozitojnë një garanci bankare, në një vlerë prej 500 000 \$;

b) të sigurojnë pjesë këmbimi, shërbimi dhe asistencë teknike;

c) të kenë të paktën tri qendra shërbimi në Republikën e Shqipërisë;

ç) të sigurojnë të paktën një shërbim mirëmbajtjeje gjatë vitit si mirëmbajtje parandaluese;

d) të sigurojnë riparim apo zëvendësim të pajisjeve fiskale, brenda 36 orëve, nga çasti kur përdoruesi i pajisjes ka kërkuar ndërhyrjen;

dh) të kenë të punësuar, të paktën, një teknik mbi jo më shumë se 1000 pajisje fiskale, në zonën e shërbimit.

Në rast të mosrespektimit të të paktën njëres prej këtyre kushteve autorizimi pezullohet për një periudhë pesë mujore.

4.3 Autorizimi nënshkruhet nga Ministri i Financave dhe shoqërohet me kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe shoqërisë së autorizuar, ku përcaktohen kushtet, që do të kenë palët respektive. Autorizimi hartohet në tri kopje dhe regjistrohet në regjistrin e autorizimeve, që mbahet në Ministrinë e Financave.

5. Kontrata lidhet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe shoqërisë së autorizuar. Në kontratë duhet të përcaktohen:

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

- a) natyra dhe objektet e veprimtarisë, që do të kryhen nga shoqëria e autorizuar;
- b) kohëzgjatja e kontratës;
- c) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- ç) detyrimet e shoqërisë së autorizuar për zbatimin e planit të biznesit;
- d) e drejta e Ministrisë së Financave dhe e institucioneve në varësi të saj, për monitorimin e respektimit të kushteve të parashikuara në këtë vendim;
- dh) kufizimi për transferimin e kontratës një subjekti tjetër;
- e) përgjegjësitë e palëve në rast të shkeljes së kontratës;
- ë) procedurat në rast se lind nevoja për ndryshime në kontratë;
- f) procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që mund të lindin ndërmjet palëve;
- g) të drejtat dhe detyrimet e palëve për informacion konfidencial;
- gj) zgjidhja e kontratës para afatit, në rast se shoqëria e autorizuar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet, në rastin e shkeljeve serioze apo në raste të tjera, që pengojnë apo nuk bëjnë të mundur vazhdimin e kontratës me shoqërinë, si dhe me pëlqimin e dyanshëm.

6. Ministri i Financave, me kërkesë të shoqërisë, ndryshon kushtet e autorizimit, si dhe kushtet që ai i gjykon të nevojshme, kur këto nuk bien ndesh me kriteret e konkurrimit për marrjen e këtij autorizimi.

7. Shoqëria e autorizuar ka të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj dhe në aktet e tjera nënligjore, që rrjedhin prej tij. Të drejtat dhe detyrimet e tij ndaj përdoruesve nuk janë objekt i këtij vendimi.

8. Përveç detyrimeve të parashikuara në ligj, detyrimeve të përcaktuara në autorizimin e dhënë, si dhe në kontratë, shoqëria e autorizuar duhet të plotësojë edhe detyrimet e mëposhtme:

8.1 Detyrimet e shoqërisë së autorizuar, që furnizon pajisje fiskale:

- a) të sigurojë miratimin e Drejtorisë së Kalibrit dhe Peshëmatjes, përpara hedhjes në treg të një tipi të caktuar të pajisjes fiskale;
- b) të sigurojë mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, kur janë të autorizuar për një shërbim të tillë;
- c) të pajisë tatimpaguesin me pajisjen fiskale, nëpërmjet së cilës ai do të regjistrojë qarkullimin, në rastet e ndalimit (ndërprerje) të përkohshëm të përdorimit të pajisjes fiskale, për arsye defekti.
- ç) të ndryshojë llojin (tipin) e ndaluar të pajisjes fiskale me llojin (tipin) e përshtatshëm dhe të miratuar.

8.2 Detyrimet e shoqërisë së autorizuar të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale:

- a) të hapë skedarin dhe të emetojë librin e mirëmbajtjes;
- b) të shkruajë të dhënat e nevojshme në librin e mirëmbajtjes;
- c) të nënshkruajë një protokoll për marrjen përsipër të mirëmbajtjes së pajisjes fiskale;
- ç) të mirëmbajë pajisjet fiskale dhe memorien fiskale, brenda kushteve të përcaktuara;
- d) të kryejë një vulosje të re të pajisjes fiskale në prani të përfaqësuesve të degës së tatimeve;
- dh) të informojë degën e tatimeve, në rastet kur tatimpaguesi ka ndërmarrë veprime për ndryshimin e të dhënave të regjistrimit të qarkullimit;
- e) të informojë tatimpaguesin, me të cilin ka kontratë mirëmbajtjeje rreth tërheqjes së autorizimit;
- ë) të marrë në dorëzim të dhënat nga memoria fiskale në prani të tatimpaguesit dhe përfaqësuesve të degës së tatimeve;
- f) të ruajë memorien fiskale në mënyrën e duhur.

8.3. Detyrimet e shoqërisë së autorizuar në marrëdhëniet me organet shtetërore:

- a) Shoqëria e autorizuar ka të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga ligji për procedurat tatimore. Ajo duhet të lejojë autoritetet e Ministrisë së Financave të kryejnë kontrollet e nevojshme, duhet të

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

jetë e gatshme të paraqesë, sa herë që kërkohen nga autoritetet, të gjitha dokumentet që ajo disponon dhe të japë ndihmën e nevojshme për ekzaminimin, fizik dhe dokumentor, të pajisjeve fiskale, në pronësi të tatimpaguesit.

b) Shoqëria e autorizuar duhet t'i japë përfaqësuesit të Ministrisë së Financave të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për veprimtarinë, që kryhet për pajisjet fiskale, të kërkuar nga kjo ministri.

9. Kontrolli i punës i shoqërive të autorizuara të mirëmbajtjes, si dhe kontrolli i kushteve, teknike dhe funksionale, të pajisjeve fiskale, për të cilin më parë është dhënë autorizimi, mund të përmirësohet në bazë të kërkesave shtesë të administratës tatimore, ose të përdoruesve të pajisjeve fiskale. Ky kontroll drejtohet nga Ministria e Financave, e cila krijon një grup pune, të përbërë nga përfaqësues të kësaj ministrie, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, administratës tatimore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mjeteve Matëse dhe Kalibrimit. Kontrolli i pajisjes fiskale kryhet pa prishur vulën e pajisjes fiskale.

10. Nëse në kontrollin shtesë është përcaktuar se një tip i caktuar i pajisjes fiskale nuk plotëson funksionin e kërkuar dhe karakteristikat teknike, Ministria e Financave ndalon përdorimin e këtij tipi të pajisjes fiskale dhe në një vendim të dytë dhe urdhëron shoqërinë e autorizuar, për të eliminuar parregullsitë, brenda një afati 3-mujor, në të kundërt Ministria e Financave ndalon përgjithmonë përdorimin e këtij tipi, të pajisjes fiskale.

Në rastin e paragrafit të parë të kësaj pike, shoqëria e autorizuar është e detyruar të pajisë tatimpaguesin me pajisje fiskale, nëpërmjet së cilës do të regjistrohet qarkullimi.

Në rastin kur nuk mënjanojnë parregullsitë e vërejtura brenda afatit të caktuar, shoqëria e autorizuar detyrohet ta ndryshojë këtë tip të pajisjes fiskale, brenda tre muajve.

11. Nëse konkludohet se shërbimi i mirëmbajtjes i ofruar nga shoqëria e autorizuar, nuk funksionon në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, Ministria e Financave heq autorizimin për mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale. Administrata tatimore, furnizuesit e autorizuar të pajisjeve fiskale dhe shoqëria e autorizuar për mirëmbajtje, njoftohen për heqjen e autorizimit. Tatimpaguesi, i cili ka kontratë mirëmbajtjeje të pajisjes fiskale me një shoqëri të autorizuar për mirëmbajtje, të cilës i është hequr autorizimi, është i detyruar të lidhë kontratë me persona të tjerë, të autorizuar për mirëmbajtje.

12. Ministria e Financave ka detyrë të kontrollojë dhe të mbikëqyrë, në mënyrë të vazhdueshme, funksionimin e pajisjeve fiskale. Detyrat e përfaqësuesit të Ministrisë janë, si më poshtë vijon:

a) të mbikëqyrë dhe të kontrollojë veprimtarinë e shoqërive të autorizuara, në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencë dhe në kontratën, që lidhet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe shoqërisë së autorizuar;

b) për çdo shkelje të vënë re të procedojë për vendosjen e gjobave deri në propozimin për heqjen e autorizimit. Masat administrative përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe shoqërisë së autorizuar.

13. Shoqëritë e autorizuara, të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e regjistruarve fiskalë, në bazë të autorizimit që kanë marrë nga Ministri i Financave, do të mbajnë të tilla autorizime deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 722 dt. 01.09.2010, FI.Z. Nr. 130, dt. 27 shtator 2010).

III. Dispozita transitorë dhe të fundit

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

1. Regjistrimet elektronike nëpërmjet pajisjeve fiskale ekzistuese mund të vazhdojnë të përdoren për regjistrimin e qarkullimit, vetëm me kushtin që karakteristikat e tyre teknike dhe funksionale, të jenë në përputhje të plotë me kërkesat e këtij vendimi.

Këto pajisje duhet të krijojnë një procedurë inicializimi pajisje fiskale-mod em-SIM dhe informacioni që do të dërgohet do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 8.1.1 të këtij vendimi me përjashtim të çelësit asimetric publik. Këto pajisje mund të krijojnë firmën elektronike përmes një çelësi simetric privat që pajisja fiskale e krijon në fazën e inicializimit pajisje fiskale-modem-SIM. Ky çelës transmetohet bashkë me informacionin sipas pikës 8.1.1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve përmes rrjetit të komunikimit GPRS. Algoritmi që do të përdoret për këtë qëllim do t'u komunikohet shoqërive nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve. Përdoruesit e pajisjeve fiskale ekzistuese duhet të sigurojnë kontratë shërbimi mirëmbajtjeje me një shoqëri të autorizuar nga Ministria e Financave. Pajisjet dhe sistemet fiskale, përfshirë dhe skemën e lidhjes para se të vihen në zbatim miratohen nga komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, dt. 17.02.2010, FI.Z. Nr. 24, dt.19 mars 2010).

2. Personat, juridikë dhe fizikë, që do të mbajnë të dhënat e xhiros, nëpërmjet pajisjes fiskale, janë të detyruar të mbajnë regjistrimet, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, sipas kalendarit të mëposhtëm:

a) brenda periudhës nëntor 2008 – maj 2009, personat e regjistruar për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin të cilët administrohen nga drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesve të mëdhenj dhe drejtoria rajonale tatimore, Tiranë;

b) brenda periudhës janar – dhjetor 2009, personat e regjistruar për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin të cilët administrohen nga drejtoritë e tjera rajonale tatimore;

c) brenda periudhës qershor 2010, personat e regjistruar në biznesin e vogël, të cilët ushtrojnë veprimtari në bashkitë e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Sarandës, Korçës, Pogradecit, Elbasanit, Shkodrës e Lezhës. Po brenda këtij afati, janë të detyruar të mbajnë regjistrime, nëpërmjet pajisjeve fiskale edhe tatimpaguesit e biznesit të vogël në komunat: Shëngjin, Golem, Rashbull, Orikum, Himarë dhe Ksamil;

ç) brenda periudhës dhjetor 2010, të gjithë tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 1467 dt. 12.11.2008, FI.Z. Nr. 177, dt. 02.12.2008).

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, dt. 17.02.2010, FI.Z. Nr. 24, dt.19 mars 2010).

Për biletat e Lotarisë Kombëtare, të miratuara nga Ministri i Financave, kompania e licencuar për ushtrimin e Lotarisë Kombëtare me ligjin nr. 95/2013 "Për miratimin e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar dhe shoqërisë "Oesterreinische Lotterien", GmbH, nëpërmjet shoqërisë "OLG Project" sh.p.k., nuk është e detyruar të instalojë e të përdorë pajisje fiskale. Biletat e Lotarisë Kombëtare janë kupon fiskal.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 354, dt. 9.05.2013, botuar ne FI. Z. Nr. 73, dt. 24.04.2013).

Nuk janë të detyruar të përdorin pajisje fiskale, sipas kërkesave të këtij vendimi, ambulantët dhe shërbimi i transportit, të përcaktuar në shtojcën nr.5 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"

d) menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, tatimpaguesit me TVSH dhe që janë subjekt i biznesit të vogël.

Vendim nr. 781, datë 14.11.2007.

3. Brenda një periudhe kohore 1-mujore shoqëritë e autorizuar janë të detyruara të verifikojnë procesin e certifikimit të pajisjeve, të sistemeve fiskale dhe të mënyrës së lidhjes të zbatuara të cilat nuk janë të pajisura me autorizimin e lëshuar nga komisioni i krijuar nga Ministri i Financave sipas pikës 13/1 të këtij vendimi

4. Në rastet kur pajisjet, sistemet fiskale dhe lidhjet përkatëse nuk përmbushin kërkesat e shprehura nëpërmjet këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, Komisioni cakton një afat kohor prej 4 muajsh brenda të cilit shoqëritë e autorizuar duhet bëjnë zëvendësimin e pajisjeve fiskale, sistemeve fiskale apo lidhjeve përkatëse, me shpenzimet e tyre. Në rast se ato refuzojnë që me shpenzimet e tyre të zëvendësojnë brenda afatit të përcaktuar më sipër, pajisjet fiskale që nuk i plotësojnë karakteristikat e këtij vendimi, përfshi dhe skemën e lidhjes, Ministria e Financave rimbursos tatimpaguesin duke tërhequr garancinë që ka lënë shoqëria përkatëse e autorizuar. Përgjegjësia e Ministrisë së Financave për rimbursim, shtrihet deri në vlerën që shoqëria përkatëse ka lënë si garanci për zbatimin e kontratës nga ana e saj.

Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministria e Financave dhe shoqëritë e autorizuar, rishikojnë kontratat përkatëse me qëllim pasqyrimin e kushteve të këtij vendimi. Refuzimi për të arritur një marrëveshje mes palëve, përbën shkak për heqjen e autorizimit të shoqërisë së autorizuar.

(Ndryshuar me Vendim Nr. 96, dt. 17.02.2010, FI.Z. Nr. 24, dt.19 mars 2010).

5. Vendimi nr.243, datë 2.4.2001 i Këshillit të Ministrave "Për detyrimin e lëshimit të kuponëve tatimorë me anë të arkave regjistruese", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.166, datë 14.11.2007

Ndryshuar me Vendim Nr. 1467 datë 12.11.2008 botuar në fletoren Zyrtare Nr. 177, datë 02.12.2008.

Ndryshuar me Vendim Nr. 1286, datë 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 192, dhjetor 2009.

Ndryshuar me Vendim Nr. 96, datë 17.02.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 24, datë 19 mars 2010.

Ndryshuar me Vendim Nr. 722 date 01.09.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 130, dt. 27 shtator 2010.

Ndryshuar me Vendim Nr. 600, datë 05.09.2012, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 129, dt. 5.10.2012.

Ndryshuar me Vendim Nr. 126, datë 13.2.2013, botuar në Fletoren zyrtare nr. 26, datë 7.03.2013.

Ndryshuar me Vendim Nr. 354, datë 9.05.2013, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 73, datë 24.04.2013.

Ndryshuar me Vendim Nr. 349, datë 29.04.2015, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 72, datë 11.05.2015.

Ndryshuar me Vendim Nr. 651, datë 31.10.2018, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 157, datë 07.11.2018